



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 26, datë 25.09.2024

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “KOMPLEKS REZIDENCIAL
SHËRBIME HOTELERI DHE BANIM, 1, 2 DHE 23-24 KATE MBI TOKË
ME 3 KATE PARKIM DHE SHËRBIME NËNTOKË”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VLORË**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligj Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar si dhe në zbatim të VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërisë “EN Construction” sh.p.k dhe “DAKZ” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks rezidencial shërbime hoteleri dhe banim, 1,2 dhe 23-24 kate me 3 kate parkim dhe shërbime nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “EN Construction” sh.p.k dhe “DAKZ” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 39, datë 18.10.2023 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Kompleks hoteleri dhe rezidencial “Luzaj Tower”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Eral Construction” sh.p.k”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT


MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 19/05/2025